VENDIM
Nr. 91, datë 20.4.2018

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË *"WIND POWER ALBANIA"* SHPK, PËR LICENCIMIN NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, si dhe në zbatim neneve 4, pika 1, germa "d"; 5, pika 1, germa "d" dhe 10, pikat 1 dhe 3 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016; neneve 15 dhe 19, pika 1, germa "a" të "Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE Nr. 96, datë 17.6.2016; bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 20.4.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut; për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë *"Wind Power Albania"* sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria *"Wind Power Albania"* sh.p.k., ka aplikuar në ERE për t'u pajisur me licencë në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 164 prot., datë 7.2.2018.

- Aplikimi i shoqërisë *"Wind Power Albania"* sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germat "a", "b", "c") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat "a", "b", "c", "d", "e") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat "a", "b", "d") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, germat "a", "b", "c" dhe "f") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për dokumentacionin e munguar, që ka të bëjë me:

- Nenin 9, pika 4.7, germa "e" (sistemin IT)

- Nenin 9 pika 4.7.1 germat "a" (të dhënat për klientët dhe energjinë e furnizuar), "b" (niveli i tensionit dhe mënyra e realizimit të matjes për klientët) dhe "c" (kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e këtij aktiviteti), do të njoftohet subjekti që në bazë të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", t'i paraqesë ato në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë *"Wind Power Albania"* sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti